

AKT-THEMELIM
I
SHOQËRISË

Union-Parts sh.p.k.

Ne mbështetje të Ligjit Nr.9901,dt. 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”,
UNE, :

1-Fatjon Memaj i biri i Bujar-it e datelindjes 31-08-2000, lindur e banues ne Prizren i paisur me leternjoftim me Nr.1232462198.

Sot me dt. 03/11/2025, me vullnetin tim të lirë dhe të plotë, vendosa të hartojë këtë **Akt-Themelimi** për krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar **Union-Parts** sh.p.k. si

ORTAKET.

Akti i Themelimit hartohet me këto kushte:

Neni 1

Ortaku , me gjeneralitetet e mësipërme, me vullnet të lirë dhe të plotë krijoj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar **Union-Parts sh.p.k.** .

Neni 2

Shoqëria vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shoqërive tregtare dhe në përputhje me dispozitat e Statutit që i bashkëlidhet këtij Akt – Themelimi.

Neni 3

Emri i plotë i shoqërisë është **Union-Parts** sh.p.k. .

Neni 4



Selia e shoqërisë është në , Kukes, Lagjja Zona Industriale, Rruga Mehmet Hoxhe Brruti, Zona Kadastrale Nr.2315, Nr.Pasurie 43/32. Sipas dispozitave të përcaktuara në Statut dhe në Akt – Themelimit, veprimtaria e shoqërisë do të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj, duke krijuar filialet apo degët e saj.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar **Union-Parts** sh.p.k. do të jetë ai i përcaktuar në Statutin e Shoqërisë :

Neni 6

Kapitali themeltaz i shoqërisë do të jetë **100.000 (njqind mije) leke** ndare në **1** kuote . Kapitali themeltaz mund të rritet sipas dëshirës së ortakut dhe kushteve në të cilat ushtrën veprimtarinë, në formën dhe mënyrën e parashikuar në Statut.

Neni 7

Administrator i Shoqërisë do të jetë **Z.Fatjon Memaj** dhe kompetencat e tyre përcaktohen në Statut.

Neni 8

Viti financiar i Shoqërisë mbyllet me 31 Dhjetor, ora 24⁰⁰ të çdo viti kalendarik. Bilanci vjetor i veprimtarisë së shoqërisë përfundohet brenda muajit Mars të vitit të pasardhës.

Neni 9

Shoqëria gëzon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare dhe ka të drejtë ti përdorë ato në përputhje me objektin dhe qëllimin e veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 10

Ky Akt-Themelin do të jetë efektiv nga dita e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar. Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat të caktuar.

Për Shoqërinë

Union-Parts shpk

ADMINISTRATORI

Ortaku

Fatjon Memaj

